

Hapet thirrja për aplikime për bursa trajnimi në Universitetin e Granadës në Spanjë, për stafin e Universitetit të Tiranës i cili merret me administrimin e bursave të Programit Erasmus + KA 107.

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për trajnim në Universitetin e Granadës në Spanjë, për stafin e Universitetit të Tiranës i cili merret me administrimin e bursave të Programit Erasmus + KA107.

Llojet e mobilitetit /kohëzgjatja:

-Shkëmbimin e stafit i cili merret me administrimin e bursave të Programit Erasmus + KA 107/ 5 ditë+2 ditët e udhëtimit;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për stafin (120 EUR në ditë);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin i cili merret me administrimin e bursave të Programit Erasmus + KA 107:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze niveli B2);

- Plani i mobilitetit për trajnim*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf

*Plani i Mobilitetit për trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Afati për aplikim: 06 Nëntor 2017

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara në formatin PDF dhe të dërgohen në adresën iro@unitir.edu.al .

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!